

VENDIM
Nr. 320, datë 15.5.2019

PËR STATUSIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOORDINUES TË DIASPORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të nenit 5, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës, gjatë kohëzgjatjes së mandatit dhe ushtrimit të aktiviteteve të tyre, gëzojnë status të veçantë në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.

2. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës, në funksion të përmbushjes së detyrave për mbrojtjen dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës, kanë të drejtë:

a) të kërkojnë informacion me interes në fushën e përgjegjësisë që mbulojnë nga institucionet shtetërore përgjegjëse;

b) të propozojnë akte administrative pranë institucioneve shtetërore që lidhen me interesat e komuniteteve shqiptare në diasporë;

c) të marrin pjesë në seanca dëgjimore në Komitetin Shtetëror të Diasporës ose komisionet e Kuvendit të Shqipërisë për çështje që kanë të bëjnë me interesat e diasporës shqiptare;

ç) të pajisen me një adresë zyrtare nga *domain*-i: @diaspora.gov.al.

3. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës gëzojnë të drejtën e trajtimit me prioritet të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë nga ambasadorët e jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të Shqipërisë si dhe nga drejtuesit e misioneve diplomatike në vendet përkatëse, sa herë që është e domosdoshme për mbarëvajtjen e punës.

4. Përgjegjësitë profesionale të përdorimit të fondeve dhe ato administrative për Këshillin do të ushtrohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

5. Agjencia Kombëtare e Diasporës kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Koordinues të Diasporës shqiptare.

6. Shpenzimet për udhëtimin, akomodimin dhe dietat për realizimin e mbledhjeve zyrtare të anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës mbulohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Kombëtare për Diasporën, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe